



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.28/2018
Prishtinë, më 22.5.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Dardan Molliqaj, Mimoza Kusari – Lila, Memli Krasniqi dhe Bilall Sherifi, anëtarë.

Munguan: Hykmete Bajrami, Gani Dreshaj dhe Duda Balje, anëtarë.

I ftuar: z. Musa Shabani, kryesues i bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM.

Pjesëmarrës të tjerë: Avdi Konjuhi, Festim Kutllovci, Azem Rexhaj, Kemajl Zeqiri dhe Ramiz Krasniqi – KPMM; Etleva Malushaj – GP/PSD, Adelina Hasani – KDI, Dardan Abazi – INDEP, Liridon Gashi – SEEF, Blerta Bejtullahu – EU Office, Donika Osmani – Ekonomia online dhe Albulena Bytyçi – Radio Kosova.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.5.2018;**
3. **Votimi i Raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës – AKK për vitin 2017;**
4. **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM për vitin 2017;**
5. **Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;**
6. **Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Dardan Sejdiu propozoi që pika e pestë e rendit të ditës Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit për Masat Mbrojtëse në Importe të hiqet nga rendi i ditës për shkak se grupi punues ende nuk e ka përfunduar raportin me amendamente.

Rendi i ditës u miratua, me ndryshimin e propozuar nga z. Sejdiu.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.5.2018

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 16.5.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Votimi i Raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës – AKK për vitin 2017

Kryetarja theksoi se për këtë pikë të rendit të ditës është shterur debati në mbledhjen e fundit dhe e hodhi për votim.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

- I. I rekomandohet Kuvendit të miratohet Raporti vjetor i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK) për vitin 2017.*
- II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet deputetja Sala Berisha Shala, kryetare e Komisionit.*

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM për vitin 2017

Kryetarja theksoi se raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale e kemi marrë me kohë dhe sipas procedurës sot e kemi në shqyrtim në Komision. Kryetarja falënderoi institutin INDEP për analizën që ka bërë për këtë raport. Në vazhdim ajo parashtroi disa pyetje për përfaqësuesit e KPMM-së. Të sqarohen Katalogu i sistematizimit të vendeve të punës që është ngritë nga Ministria e Administratës Publike dhe numri i madh i departamenteve? Të cekni rezultatet nga udhëtimet zyrtare të realizuara, këto do të duhej edhe të përfshiheshin në raport? A ka lëshuar KPMM për ndërmarrjet e licencuara të cilat nuk kanë punuar sipas planit të shfrytëzimit dhe a ka marrë edhe masa të tjera ligjore? Tregoni për numrin e licencave të skaduara? A ka pasur rehabilitim dhe rikultivim në zonat ku janë shfrytëzuar më parë? A janë paditë kompanitë e sigurimit apo kompanitë minerare që nuk i kanë rikultivuar zonat? Në raport janë paraqitur sfidat dhe rekomandimet, por detyrë e KPMM-së është me zbatuar ligjin e jo me dhënë rekomandime. Çka është ndërmarrë lidhur me planin e veprimit për ndalimin e operimeve ilegale? Pse është numër shumë më i madh i licencave të hulumtimit krahasuar me licencat për shfrytëzim për mineralet metalore? Sa licenca janë pezulluar dhe anuluar?

Musa Shabani, kryesues i bordit të KPMM-së, prezantoi raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017. Ai theksoi se raporti në mënyrë përmbledhëse, analitike dhe të hollësishme pasqyron të dhënat e punës së KPMM-së gjatë vitit 2017, të dhëna të hollësishme mbi industrinë minerare në Republikën e Kosovës, si dhe paraqet vështirësitë dhe sfidat që e kanë përcjellë këtë agjenci gjatë vitit 2017. Brenda vitit 2017, janë lëshuar 186 Licenca dhe Leje (Hulumtim 89, shfrytëzimi 31, dhe Leje për Aktivitet të Veçantë 66). Inspektorati i KPMM-së gjatë vitit 2017 ka pasur një dinamikë të lartë pune të vizitave ose inspektimeve në terren. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 1770 vizita gjegjësisht inspektime në terren. Këtë numër e përbëjnë: 159 vizita të rregullta, 1443 inspektime të kërkesave dhe lejeve për minime masive, 27 vizita për të cilat janë lëshuar vërejtje, 79 inspektime për veprimtari të jashtëligjshme për të cilat janë punuar raporte, si dhe 62 vizita për matje pas inspektimeve për veprimtari minerare të jashtëligjshme. Në këtë vit janë përcjellë 76 kallëzime penale në Prokuroritë kompetente, në bazë të raporteve që kanë ardhur nga terreni, për operime pa licencë dhe janë në procedure të shqyrtimit nga gjykatat kompetente. KPMM gjatë vitit 2017 ka përgatitur 80 aktvendime për gjoba administrative lidhur me operimet e pa licencuara, duke respektuar ligjet dhe normat ligjore në fuqi. Si sfida gjatë vitit 2017 z. Shabani përmendi: ngritjen e kualitetit dhe sigurisë në punë në veprimtaritë minerare, vonesat në trajtim të lëndëve në gjykata, problemet me operimet ilegale, inkasimin e borxheve, realizimin e Planit për Menaxhimin e Resurseve Minerale. Në vazhdim ai paraqiti disa nga faktorët kryesorë të cilët kanë ndikimin e drejtpërdrejt në krijimin e stabilitetit të sektorit minerar dhe rrjedhimisht edhe në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar, si: Zhvillimi i minierave në ndërmarrjen Trepça SHA; Mos zhvillimi i Zonave me Interes të Veçantë të shpallura nga Qeveria; Mos zhvillimi i mineraleve energjetike – linjitet – mungesa e bazës ligjore adekuate për të nxitur shfrytëzimin e këtij resursi; Nevojat për investime afatgjata në hulumtime për zbulim të zonave të reja të pasura me minerale metalike. Në fund z. Shabani potencoi se nga ajo që ishte në të kaluarën sot sektori i minierave në Kosovë është në një stad më të avancuar dhe më të zhvilluar, përkundër shumë vështirësive që kemi si një shtet i ri, si një shtet në formim dhe i cili dëshiron dhe po punon pandalshëm në krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e biznesit e me këtë edhe të sektorit minerar, që të krijoj një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, i cili do të jetë në shërbim të mirëqenies sonë dhe do të krijojë kushte edhe më të mira për brezat që do të vijnë pas nesh.

Dardan Molliqaj theksoi se sektori minerar nuk ka pasur një plan të mirë që do të ndikonte në zhvillimin ekonomik. Në vitin 2017 janë rritur kallëzimet penale, që do të thotë se janë rritur operimet ilegale, e që i bie se nuk e keni bërë punën mirë. Pse janë rritur kallëzimet penale? A keni ndërmarrë ndonjë iniciativë me Qeverinë për zvogëlimin e operimeve ilegale? A keni bërë inspektime të të licencuarve nëse janë apo jo duke operuar në përputhje me licencën? Raporti i auditorit i ka disa gjetje dhe ju nuk i keni përfshirë, na sqaroni lidhur me gjetjet e auditorit? Pse gjobat nuk po inkasohen me përmbarues privat? Nga gurthyeset janë të prekura sidomos Istogu dhe Klina, ku nga operimet minerare janë dëmtuar rrugët, janë degraduar lumenjtë, pse po ndodh ky degradim dhe çka keni ndërmarrë për parandalim të degradimit? Të jepni detaje për investimet kapitale? Të sqaroni shpenzimet sipas kategorive sepse janë mjaft të larta sidomos për web-faqe, telefon, karburante, etj.? Pse nuk është i hapur portali por vetëm përmes regjistrimit?

Kryetarja pyeti se borxhi i Trepçës a është vetëm për Trepçën apo për të gjitha njësitë e Trepçës?

Musa Shabani, KPMM, duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve sqaroi se borxhi është për të gjitha njësitë e Trepçës. Sa i përket operimeve ilegale, kemi punuar në promovimin medial për parandalim të operimeve ilegale. Zakonisht kur po mungon stabiliteti politik, siç ishte edhe gjatë vitit 2017, veprimet ilegale po shënojnë rritje. Ne kemi ngritur kallëzime penale, po presim veprime meritore nga gjykatat. Numri i licencave për hulumtim është shumë më i madh se ai për shfrytëzim për mineralet metalore, sepse hulumtimet bëhen që të gjenden potenciale minerare, por ende nuk është arritur të vlerësohen potencialet minerare në mënyrë që të vazhdohet me shfrytëzim. Lidhur me deklarinimin se ka bartje të licencave në mënyrë të jashtëligjshme, ju siguroj që nuk kemi asnjë bartje të jashtëligjshme të licencave. Nëse keni informatë për ndonjë rast konkret na e tregoni dhe do ta vërtetojmë. Ju sigurojmë se bartja e kontrollit përkatësisht licencës bëhet në pajtim të plotë me ligjin në fuqi. KPMM ka marrë me seriozitet të gjeturat e auditorit dhe pesë prej tyre janë plotësuar, ndërsa tri janë në proces sepse ndërliidhen me borxhet e vjetra. Guroret dhe degradimi i lumenjve janë sfida dhe këto kërkojnë angazhim më të gjerë institucional. Lidhur me këtë ne i kemi propozuar Qeverisë një Plan të veprimit, por ky Plan nuk është miratuar në Qeveri. Web-faqja ka çmim të lartë sepse janë dashur module me software për lidhje me GIS portal dhe GEO portal. Kjo web-faqe përmban informacione, harta, të dhëna të shumta për potencialin, dhe të gjitha këto janë në funksion të investitorëve që t'i shohin në web-faqe se ku mund të investojnë, si mund të investojnë, ku janë licencat aktive, etj. Qasja në web-faqe është e hapur për të gjithë, por regjistrimi me "user" ka të bëjë me të dhënat gjeoshkencore të cilat shfrytëzohen nga ekspertë, dhe për me pa se kush po i shfrytëzon ato të dhëna.

Azem Rexhaj, KPMM, sqaroi se web-faqja ka qenë në dy loto, dhe vetëm web-faqja ka kushtuar 9 mijë euro, ndërsa loto 2 që ka pasur të bëjë me GIS portalin dhe GEO portalin dhe kanë qenë shumë më specifik, si gjeodatabazë që i mundëson investitorëve qasje në të dhëna gjeoshkencore. Të dhënat e përgjithshme janë pa "user" ndërsa të dhënat gjeoshkencore me "user". Shpenzimet që ndërliidhen me karburante, veshmbathje, telefon janë si rezultat i punëve në terren që kanë shumica e stafit të KPMM-së, dhe veshmbathja që kërkohet sipas mbrojtjes në punë, si dhe veturat e vjetra që i kemi po shpenzojnë më shumë. Te kategoria shpenzimet e tjera hyjnë shpenzimet TAXI, për regjistrim, do të thotë këto konsiderohen shpenzime të tjera, sepse nuk kanë kod buxhetor. Lidhur me operimet ilegale, KPMM ka propozuar Planin e veprimit, por Qeveria nuk e ka miratuar ende. Kemi institucionet e Kosovës që kur japin kontrata për ndërtim të rrugëve nuk sigurohen që materialet e përdorura mos të jenë nga operimet ilegale. Sa i përket inkasimit të borxheve me përmbarues privat, ne çdo borxh e dërgojmë te përmbaruesi privat, por operuesit ilegal nuk kanë llogari bankare.

Festim Kutllovci, KPMM, theksoi se kemi mbajtur tryeza për ndalimin e operimeve ilegale. Gjykatat dënimet i japin me gjobë. Ne kemi kërkuar që dënimet të jenë edhe me sekuestrim të mjeteve.

Kryetarja potencoi se me projektligjin e ri jemi munduar të adresojmë masat për ndalimin e operimeve ilegale.

Kemajl Zeqiri, KPMM, theksoi se lidhur me guroret i kemi rekomanduar MZHE-së me ndaluar përkohësisht shfrytëzimin e gurit të fortë për tri vitet e ardhshme.

Ramiz Krasniqi, KPMM, theksoi se së bashku me Inspektoratin e KPMM-së të gjithë kryetarëve të komunave ja kemi dërguar një njoftim me shkrim që gjatë punimeve të rrugëve dhe tenderëve që i shpallin komunat mos me marrë material ilegal. Kështu kemi vepruar edhe me ministri. Askush nuk e ka përfillë. Operuesit ilegal po shprehëm thjesht e kanë lidhjen në pushtet. Shumica e atyre që shtrojnë rrugë marrin edhe material ilegal.

Mimoza Kusari-Lila theksoi se përveç ekzekutivit, komunave dhe në këtë rast ministrisë së infrastrukturës si tenderuesja më e madhe për ndërtim të rrugëve, është mirë që edhe Autoriteti Rregullator i Prokurimit Publik ta ketë të drejtpërdrejtë informatën dhe në momentin e verifikimit të kontratave të tilla me pasur mundësinë e anulimit. Nëse nuk ka vullnet politik ose nëse nuk ka transparencë nga ekzekutivi dhe komunat atëherë ekziston edhe një autoritet tjetër që të paktën mundet me i ndalur, edhe kjo mundet me qenë arsyeja për me pasur anulim të kontratave.

Në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, komisioni nxori këtë:

Konkluzion

Shtyhet për mbledhjen e radhës votimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM për vitin 2017.

5. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Kryetarja i njoftoi anëtarët e komisionit se informata për udhëtimin zyrtar në Bruksel/Belgjikë, 23-25 prill 2018, lidhur me pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit të Kosovës, Sala Berisha-Shala dhe Dardan Sejdiu, në mbledhjen e Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë, si dhe informate e udhëtimit zyrtar të deputetes Mimoza Kusari-Lila në SHBA, 23-27 prill 2018, me temë “Konsulenca Amerikane për Minierat në Kosovë”, janë shpërndarë në kutitë e deputetëve.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA